

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Pa asnjë diskutim, tradicionalisht, diskutimi i buxhetit është quajtur diskutimi i vitit, se nuk ka si të quhet ndryshe, i cili, normalisht, është momenti i madh i përgjegjshmërisë politike, pasi është përdorimi aty ku duhet, me efikasitet i parave që mblidhen nga gjaku dhe djersa e mijëra njerëzve, të cilët punojnë, robtohen dhe njëkohësisht paguajnë taksa. Nuk është dita dhe vendi për të shfryrë të gjithë dufin psikologjik, psikopatik, dufin e të mbeturit peng gjëkund, dufin e paradhënieve të marra, për të cilat duhet të bësh ligje e të qeverisësh në mënyrën më të pistë të mundshme.

Ashtu siç dëgjuam prezantimin e buxhetit, dua të them, në mënyrë historike, për sa i takon skizofrenisë nga Kryeministri i vendit, sot shqiptarët kanë kuptuar një gjë, që motoja e qeverisë është: “Fajin e ka Putini!”. Kjo fjalë kyçe, duket që është një mesazh i dhënë në inbox, është një refren idiot (nuk besoj se ofendoj njeri kur e them këtë, se me ato që kemi dëgjuar në mëngjes, këto janë gjëra minore dhe janë brenda etikës së Kuvendit).

Çdo njeri që na dëgjon, me shumë qetësi do të pyeste: “Si shpjegohet që këta qajnë për Putinin?! Ata që bëjnë luftë në Ukrainë, kanë çmime ku e ku me të Shqipërisë. Si është e mundur kjo?! Se atje është vendi i luftës”. Mundësitë e spekulimit për shkak luftës janë të njohura historikisht. Pse nuk ndodhin atje, por vijnë këtu, në zonën tonë gjeografike? Si do t’u kthejmë përgjigje për çmimet që kanë Maqedonia e Veriut dhe Kosova? Ku është përgjigjja? A janë më larg se ne nga lufta ata? Gjeografikisht, në fakt, janë disa kilometra më afër sesa ne me Rusinë. Është shumë e qartë që këtij shpjegimi të pacipë e të paturp, kësaj “gozhdës së radhës se ku duhet të varin pallton”, duhet t’i jepet fund njëherë e përgjithmonë! Diferenca është vetëm kaq: cili është projektimi, motivi dhe mënyra e të punuarit e kësaj qeverie, të vjedhë, të grabisë apo të punojë për njerëzit? Sigurisht, është zgjedhur e para. Kjo është shumë e qartë dhe këtu nuk ka dilemë.

Nuk ka asnjë argument dhe asnjë element që ky buxhet do t’u përgjigjet ekzigjencave të mëdha dhe halleve që kanë njerëzit. Vetëm një gjë është shumë e qartë, që njerëzit do të vazhdojnë të grabiten

njësoj e do të vazhdojnë të paguajnë nga taksat e tyre miliarda, jo miliona, për të larë borxhet që marrin këta, të cilat nuk krijojnë asnjë efekt pozitiv për ekonominë, se edhe kur marrin 100, investojnë 80, në vend që të investojnë 180, pra që borxhi të krijojë produktivitet. Këto gjëra janë të provuara edhe nga institucionet ndërkombëtare, nuk janë shifrat e mia. Pra, shqiptarët punojnë për të larë borxhet që marrin këta për të përvetësuar para.

Shqiptarët nuk kanë nevojë të dëgjojnë idiotësira, po e them sërish, si “mburoja”, si “armiku”, të cilin ne e mposhtim, ai tërhiqet dhe ne e sulmojmë prapë. Çfarë janë këto mburoja? Ku është mburoja sociale? Një letër që është çarë e është bërë vrima-vrima! Po si u dhënka mburoja sociale mbështetje pensionistëve tanë me 10 mijë lekë të vjetër, kur Kosova u jep 100 euro?! Çfarë mburoje është kjo?! Çfarë mund t’u shpjegoni njerëzve? Si mund të jetë paturpësia kaq e madhe?! Ata japin 120 mijë lekë, nëse do t’i konvertojmë, ndërsa ky jep 10 mijë lekë të vjetër dhe thotë: “Po, mburoja ime është më e mirë!”.

Thotë: “Po bëjmë mrekulli me energjinë elektrike!”. Çfarë mrekullie ke bërë me të, përveçse e ke vjedhur, e ke grabitur, ke batërditur afro 1 miliardë euro vetëm për humbje teknike, dhe energjinë e ke po njësoj?!

Sot, në një analizë të fundit, çfarë mbetet? Le ta dinë shqiptarët, ta kenë të qartë në kokën e tyre se kanë çmimet më të larta në Ballkan. TVSH-ja e energjisë në Shqipëri është 20%, ndërkohë që në Kosovë është 8% dhe në Maqedoninë e Veriut 5%.

Sa është çmimi i karburantit në Shqipëri? Është 2400 lekë të vjetër, ndërkohë në Maqedoninë e Veriut është 1800 lekë të vjetër, në Kosovë është 1900 lekë të vjetër, ndërsa në Malin e Zi është 1600 lekë të vjetër.

A nuk ekziston Putini atje?! Vetëm këtu te ne është?! Le ta sjellin Putinin këtu, le të sjellin edhe një mulazh të tij, ta vënë si anëtarin e 21-të të qeverisë e të thonë: “Këtë e kemi aleatin më të mirë. Shyqyr që na u gjend, që të gjejmë alibi për ato që vjedhim e grabisim!”.

Po ku hyn Putini këtu?! Apo hyn në bujqësi, ku prej vitit 2006, që nuk mbahet mend, importi i zarzavateve drejt Shqipërisë është rritur me 40 e ca për qind? Në vendin me diell, në Shqipëri, me klimë dhe tokë të shkëlqyer, ku mund të prodhohet 2-3 herë në vit, importohen zarzavate. Kështu i kemi punët në rregull me qeverinë ne?! Sa subvencione japin Maqedonia e Veriut dhe Kosova? Pse këta tanët japin 4 herë më pak? Përse ky buxhet nuk i kthen këto përgjigje? Është shumë e thjeshtë, çdo qytetar i

këtij vendi, kur shikon këta, meqë u përdor termi “mallkim” sot, thotë me gojën plot: “Mallkuar qofshi! Bekuar qofshin ata që qeverisin në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë, që ndihmojnë qytetarët e tyre!”. Si mund të mbrohen këta? A mos kanë resurse të mëdha energjetike, gjeografike, gjeopolitike, natyrore Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Mali i Zi, dhe ne nuk i kemi?! Diferenca është që ata kanë qeverisje të përgjegjshme, në raport me një qeverisje grabitqarësh dhe hajdutësh. Është shumë e qartë se në të gjitha operacionet e bëra, njëri është më mafioz se tjetri.

Po të shikoni në buxhet se cilat janë shifrat për shërbimin, për të paguar kreditë, për të paguar në mënyrë të veçantë borxhin në tërësinë e vet qoftë me përqindjet e tij, qoftë me rikthimin e tij, në total shkojnë 1,15 miliardë euro. E kuptoni? Po për çfarë? Cilin shërbim kanë më të mirë këta? Kanë shërbimin dixhital, që u shqye në të 14 anët, për të cilin kanë shkuar 300 e ca milionë euro?! Apo kanë rrugët, që janë bërë si metalurgjia në kohën e Enver Hoxhës, që nuk mbaronte ndonjëherë, ku vazhdohet të jepen para? Cili shërbim ishte më i mirë?

Ne vijmë pas pandemisë. Cili është projektimi i buxhetit të shëndetësisë pas pandemisë? Në mënyrë të përbotshme, në qoftë se duan të lexojnë 5 libra e të mos merren me politikë 24 orë, përqindja e frikshme e komplikacioneve post-pandemi ka tronditur të gjitha buxhetet e shëndetësisë në botë, që kanë përparësuar me financime ekstra pikërisht një situatë të re, pas një tsunami epidemiologjik dhe pandemik të paparë. Buxheti i shëndetësisë sonë është rutinë, është më rutinori që ka ekzistuar ndonjëherë, sikur nuk ka ndodhur asgjë, sikur nuk kemi pas pandemisë, sikur nuk kemi një pandemi ende të pambyllur! Heronjtë e pandemisë, mjekët, që nuk kanë nevojë për serenata (kush e njeh këtë profesion e di shumë mirë), por kanë nevojë për një infrastrukturë të mirë dhe të paguhen në një mënyrë dinjitoze, do të kenë një rritje page prej 6 %. Ky ishte shpërblimi për sakrificën e jashtëzakonshme të vijës së parë dhe ditirambet që u thanë këtu?! Ndërkohë që nuk ndalen koncesionet, PPP-të dhe tenderët me 99%, nuk ka lekë për mjekët, por do të ketë vetëm 6% shtesë page për ta.

Cila është sakrificë? Cila është risia? Cila është e veçanta? Çfarë ndodhi? Ndodhi që nga Kryeministri dëgjuam “Putinin” dhe “mos më zini në gojë portin e Durrësit!”. Aty kuptuam se ai ka një pikë të dobët, që i dhemb shumë. Pse i dhemb, kur ka pasur edhe Europën kundër? Se një herë na thotë: “Dëgjoni çfarë thonë ata!”, pastaj, kur vjen puna te leku, thotë: “Mos i dëgjoni!”. Cili është ky?

Ndaj, është shumë e qartë që shqiptarët kanë përballë një qeveri hajdutësh dhe grabitqarësh.

Buxheti për të cilin do të votojnë sot, është preja ku do të hidhen për ta shqyer e për ta bërë copa, për të ardhur e për të kënduar propagandën e radhës, ndërkohë që shqiptarët do të jenë më të varfër se kurrë dhe me të drejtën më të madhe se kurrë për të protestuar më fort se asnjëherë, që kjo vjedhje të ndalet dhe këta hajdutë të shkojnë në shtëpi!

Faleminderit!